



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**V E N D I M**

**Nr. 147, datë 09/08/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 12, datë 16.02.2021, e z. M.G., ku pretendohet diskriminim, për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Kamëz,

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se ankuesi M.G. ka punuar pranë Bashkisë Kamëz në pozicionin “Specialist jurist” pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, në Bashkinë Kamëz. Ai është emëruar në detyrë nëpërmjet Urdhërit nr. 288, datë 24.09.2018, të ish-Kryetarit të Bashkisë Kamëz. Z. M.G. thekson faktin se diskriminimi për shkak të bindjeve të tij politike ka filluar menjëherë pas ndryshimit të titullarit të Bashkisë Kamëz, pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019 dhe ardhjes në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë Kamëz, z. R. S., i cili përfaqëson Partinë Socialiste. Diskriminimi i ushtruar ndaj tij është reflektuar në mënyra të ndryshme, duke filluar nga dhënia e detyrave më të vështira në krahasim me punonjësit e tjerë, transferimi i tij në një grup pune pranë Njesisë Administrative Paskuqan, duke kryer kontrole të njëpasnjëshme për të verifikuar nëse ai ishte paraqitur në punë e në vijim është proceduar me vlerësime negative për performancën e tij në punë, për të mundësuar lirimin e tij nga detyra.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Z. M.G. thekson faktin se diskriminimi ndaj tij ka si shkak bindjen politike. Shkakun e pretenduar të diskriminimit, ankuesi e lidh me faktin se ai është emëruar në detyrë gjatë periudhës, kur Kryetar i Bashkisë Kamës ka qënë z. Xh. M., që është anëtar i Partisë Demokratike. Ankuesi sqaron se personalisht nuk është anëtar i asnjë partie politike.

Njëkohësisht, z. M.G. pretendon se ai është diskriminuar më shumë se një herë nga ana e Bashkisë Kamëz dhe në këto kushte ai pretendon se është ekspozuar ndaj formës së rëndë të diskriminimit, parashikuar në nenin 3/1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Me konkretisht, ankuesi pretendon se fillimisht është diskriminuar nga Bashkia Kamëz, pasi nëpërmjet Urdhërit nr. 248, datë 22.06.2020, të Kryetarit të këtij institucioni është përfshirë në grupin e punës për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave të përfundimit të proceseve kalimtare të pronësisë pranë Njesisë Administrative Paskuqan, pa asnjë afat kohor. Ankuesi pretendon se ai nuk duhej përfshirë në këtë grup pune, pasi ai nuk ishte specialist i kadastrës, por specialist jurist. Ankuesi shprehet se prezenca fizike në punë e Strukturës së Posaçme, të krijuar me aktin e sipërcituar, verifikohej nga Kryetari i Njesisë Administrative Paskuqan, i cili kontrollonte nëpër zyra për të konstatuar praninë e këtyre punonjësve. Z. M.G. shprehet se një veprim i tillë është në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të institucionit, si dhe vë në dukje faktin se ai ka dërguar pranë Bashkisë Kamëz, shkresën e datës 11.09.2020, nëpërmjet së cilës kërkon marrjen e masave të nevojshme për vënien në dispozicion të listëprezencave për të evidentuar prezencën në punë të punonjësve të strukturës së posaçme, që do të kryente detyrat përkatëse, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, pranë Njesisë Administrative Paskuqan.

Momenti vijues, ku ankuesi pretendon diskriminim për shkak të bindjes së tij, politike konsiston në vlerësimin e punës, nga ana e eprorit të tij të drejtpërdrejtë. Ai sqaron se në datën 10.08.2020 është vënë në dijeni të faktit se është vlerësuar në nivelin “*jo kënaqshëm*”, për periudhën janar-qershor 2020, nga ana e z. S.D., drejtor pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkisë Kamëz. Ankuesi shprehet se procesi i vlerësimit të rezultateve të tij në punë është kryer në kundërshtim me pikat 10 dhe 12, të Kreut II, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar. Ai shprehet se vlerësimi i tij është kryer në mënyrë të njëanshme dhe se ai nuk është njoftuar asnjëherë për fillimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, planifikimin, ecurinë e verifikimeve të rezultateve, apo të njoftohet për bisedime të ndërmjetme në mes të periudhës së vlerësimit sipas aktit nënligjor të sipërcituar. Ankuesi shprehet se eprori i tij e ka diskriminuar në vlerësimin e kryer ndaj tij, pasi ky vlerësim është kryer në kundërshtim me ligjin.

Ankuesi sqaron se ai i ka realizuar të gjithë objektivat dhe urdhërat e punës së Kryetarit të Bashkisë Kamëz, fakt i cili është i verifikueshëm, në materialet e protokolluara pranë këtij institucioni. Vlerësimi i kryer ndaj tij konsiderohet si pasojë e diskriminimit për shkak të bindjeve politike. Ai shprehet se ka 3 vjet përvojë punë si jurist dhe 2 vite eksperiencë pune pranë Bashkisë Kamëz, ku ka punuar me korrektësi dhe në mënyrë rigoroze.

Z. M.G. shprehet se e ka ankimuar<sup>2</sup> vlerësimin e tij të punës pranë Bashkisë Kamëz e në vijim pranë Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil. Me shkresën nr. 679, datë 11.09.2020, Bashkia Kamëz e ka njoftuar z. M.G., se ankimimi i tij është marrë në konsideratë dhe do të merret në rishqyrtim për një vlerësim të rezultateve në punë gjatë periudhës Janar - Qershor 2020 nga Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike pranë këtij institucioni.

Momenti tjetër, diskriminues, i pretenduar nga ankuesi M.G. ka lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 148, datë 16.11.2020, të Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) nga ana e Bashkisë Kamëz. Në këtë vendim, KMSHC ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 288, datë 24.09.2018, nëpërmjet së cilit punonjësi M.G. është emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin “*specialist jurist*” pranë Bashkisë Kamëz. Në vendimin e sipërcituar kërkohet gjithashtu rregullimi i pasojave duke shpallur të lirë pozicionin e mësipërm, për t’u plotësuar nëpërmjet konkurimit, në përputhje me kërkesat e nëpunësit civil.

Ankuesi sqaron se në vijim, Kryetari i Bashkisë Kamëz, në tejkallim të kërkesave të KMSHC-së, e ka liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 584, datë 22.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “Për lirim nga detyra”, me motivacionin “***pavlefshmëri absolute e aktit nr. 288, datë 24.09.2018***”. Sipas ankuesit, një veprim i tillë përbën diskriminim për shkak të bindjes së tij, politike. Bashkia Kamëz ka kryer lirim të menjëhershëm nga detyra, duke mos respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në Kodin e Punës, duke mos shpallur paraprakisht si absolutisht të pavlefshëm Urdhërin nr. 288, datë 24.09.2019, të ish-Kryetarit të Bashkisë.

Ankuesi pretendon se diskriminimi ndaj tij ka vazhduar edhe më tej, kur ai ka aplikuar për të konkuruar për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore*”, pranë Bashkisë Kamëz. Ky pozicion është shpallur vakant në datën 19.01.2021 dhe afati për dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e “***Lëvizjes paralele***” ishte data 28.01.2021, për procedurën e “***Ngritjes në detyrë***” ishte data 04.02.2021 dhe për procedurën “***Pranim në shërbimin civil***” ishte data 11.02.2021.

---

<sup>2</sup> Ankimimi nr. 6625, datë 31.08.2020, i z. Marjon M.G. depozituar pranë Bashkisë Kamëz dhe ankimimi nr. 679, datë 11.09.2020, i M.G. depozituar pranë KMSHC-së;

Ankuesi pretendon se në datën 20.01.2021 ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar kërkesën e tij për të aplikuar për pozicionin e sipërcituar, për procedurën **“Pranim në shërbimin civil”**, pasi i plotësonte të gjitha kriteret respektive. Kërkesa e tij është marrë në dorëzim nga Bashkia Kamëz, fakt që vërtetohet nëpërmjet lajmërim-marrjes përkatëse. Ankuesi pretendon se në datën 29.01.2021, Bashkia Kamëz ka njoftuar për mbylljen e procedurës për pranim në pozicionin e sipërcituar, me arsyetimin se nuk ka patur asnjë aplikant. Sipas ankuesit, ky është veprim diskriminues i Bashkisë Kamëz, pasi ka mbyllur procedurën e pranimit pa përfunduar të gjitha fazat përkatëse.

M.G. shprehet gjithashtu se diskriminimi ndaj tij ka vazhduar nga Bashkia Kamëz, pasi ish-pozicioni i tij i punës është shpallur vakant, pa e njoftuar atë, në kushtet kur ai kishte të drejtë legjitime të konkuronte në atë pozicion pune. Ankuesi ka depozituar kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër Bashkisë Kamëz, me objekt dëmshpërblim page për mosrespektim të procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës etj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*<sup>3</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjes politike, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të*

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a), b) e c) parashikon shprehimisht se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 12, datë 16.02.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Kamëz me shkresën nr. 308/1, datë 24.02.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
  - Kopje e Urdhërit nr. 288, datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, nëpërmjet së cilit është kryer emërimi i tij në pozicionin e punës “specialist jurist” pranë Bashkisë Kamëz;
  - Kopje e librezës së punës së ankuesit;

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

- Informacion nëse ndaj ankuesit janë marrë masa disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Bashkisë Kamëz. Nëse po, të dërgohen aktet përkatëse;
  - Kopje e Urdhërit nr. 248, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz;
  - Informacion mbi detyrat që duhet të kryente ankuesi në grupin e punës së krijuar me Urdhërin nr. 248, datë 22.06.2020, e Kryetarit të Bashkisë Kamëz;
  - Struktura organike e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkisë Kamëz;
  - Kopje të vlerësimeve në punë nga momenti i emërimit në detyrë të ankuesit Marjon M.G.;
  - Ankimi i z. M.G. lidhur me vlerësimin e tij në punë, për periudhën janar-qershor 2020, depozituar pranë Bashkisë Kamëz;
  - Shkresa nr. 679, datë 11.09.2020, e Bashkisë Kamëz drejtuar ankuesit;
  - Përgjigja e dërguar nga KMSHC mbi ankesën e z. M.G., në lidhje me vlerësimin e performancës në punë për periudhën janar-qershor 2020;
  - Kopje e Vendimit nr. 148, datë 16.11.2020, të Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil;
  - Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës për ankuesin dhe për të gjithë punonjësit, aktet e emërimit të së cilëve janë cilësuar se janë në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet Vendimit nr. 148, datë 16.11.2020, të Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil;
  - Praktika e kryerjes së procedurave ligjore për shpalljen vakant të pozicionit “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore*”, pranë Bashkisë Kamëz;
  - Kopje e kërkesës për aplikim të ankuesit për pozicionin vakant “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore*”, pranë Bashkisë Kamëz;
  - Numri i kandidatëve që aplikuan dhe konkuruan për këtë pozicion, si dhe kërkesat e depozituara prej tyre pranë Bashkisë Kamëz;
  - Informacion mbi fituesin e këtij pozicioni të shpallur vakant, duke specifikuar se cila ishte procedura përkatëse, për të cilin kandidati fitues ka aplikuar;
  - Lista emërore e punonjësve të Bashkisë Kamëz, të emëruar nga ish-Kryetari i këtij institucioni, të cilët janë larguar nga puna nga momenti i ardhjes në detyrë të kryetarit aktual të Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, duke specifikuar datën e emërimit të tyre, arsyen e largimit nga puna dhe pozicionin e punës që ata kanë mbajtur;
  - Lista emërore e punonjësve të emëruar nga ish-Kryetari i Bashkisë Kamëz, të cilët vazhdojnë ende të punojnë pranë këtij institucioni. Në listë të evidentohet edhe data e emërimit në detyrë dhe pozicioni i punës.
- Në përgjigje të shkresës nr. 308/1, datë 24.02.2021, së KMD-së, Bashkia Kamëz dërgoi shkresën nr. 2300 prot., datë 05.03.2021, nëpërmjet së cilës informon se z. M.G. është emëruar “*specialist jurist*” pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, të Bashkisë Kamëz, nëpërmjet Urdhërit nr. 288, datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë. Lidhur me



pretendimin e ish-punonjësit se diskriminimi për shkak të bindjes së tij politike ka filluar menjëherë pas ndryshimit të titullarit të Bashkisë Kamëz, ky institucion sqaron se ky është një pretendim subjektiv, i bazuar në përgjithësime të pargumentuara.

Në shkresë theksohet fakti se kryetari aktual i Bashkisë Kamëz, në asnjë moment, nuk ka ushtruar presion ndaj z. M.G., në ushtrimin e detyrave funksionale, përkundrazi ka lejuar vijimësinë e praktikave të ndjekuara në shpërndarjen e punës brenda Drejtorisë së Çështjeve Ligjore. Kryetari apo edhe stafi aktual i Bashkisë Kamëz nuk ka patur asnjëherë tendencë negative ndaj z. M.G.

Në përshkrimin e punës të pozicionit në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kamëz është cilësuar ndër të tjera që “specialist jurist” merr pjesë në grupet e punës të ngritura me urdhër të kryetarit. Në këtë rast sqarohet se për sa kohë z. M.G. në cilësinë e ish-punonjësit nuk e ka kundërshtuar me observacion Urdhërin e punës nr. 248, datë 22.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “Për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave të përfundimit të proceseve kalimtare të pronësisë pranë Njësisë Administrative Paskuqan”. Ky urdhër, sqarohet në shkresë, mbetet legjitim për nga përmbajtja dhe nga forma.

Të gjithë punonjësit duhet të karakterizohen nga parimi i bindjes dhe besnikërisë në marrëdhënien kontraktore të punës.

Në pretendimin e z. M.G. ku citohet se: “...ai nuk duhej përfshirë në këtë grup pune, pasi ai nuk kishte specialist i kadastrës, por specialist jurist”, Bashkia Kamëz sqaron se pretendimi i sipërcituar është një arsyetim që vjen jo konform logjikës së një juristi, pasi dihet nga të gjithë se juristët janë faktor në administratën publike, për të verifikuar, konstatuar, hulumtuar mbi bazën ligjore, apo paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar. Juristi, si anëtar i grupit të punës është një ndihmë dhe mbështetje e madhe për këtë grup. Në këtë kontekst, Bashkia Kamëz e kundërshton pretendimin e z. M.G. si të pafaktuar në arsyetim.

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se diskriminohet politikisht, për sa i përket vlerësimit që ishte bërë punës së tij nga eprori i tij i drejtpërdrejtë, Bashkia Kamëz sqaron se vlerësimi dhe matja e performancës në punë është në diskrecion të plotë të drejtorit/eprorit të drejtpërdrejtë të z. M.G. dhe ky vlerësim ka ardhur në bazë të bindjes së brendshme të eprorit dhe punës së faktuar mbi cilësinë, shpejtësinë dhe marrëdhëniet me kolegët, që ish-punonjësi ka reflektuar në marrëdhëniet e punës.

Lidhur me pretendimin e z. M.G. se Kryetari i Bashkisë Kamëz, në tejkallim të kërkesave të KMSHC-së, e ka liruar atë nga detyra, Bashkia Kamëz sqaron se në vendimin nr. 148, datë 16.11.2020, të KMSHC-së, është vendosur: “Të kërkojë nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, me synimin rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë absolute të aktit nr. 288, datë 24.09.2018, nëpërmjet të cilit punonjësi M.G. është emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës “specialist jurist” në Bashkinë Kamëz.” Për sa më sipër, Bashkia kamëz, në kuadër të rehabilitimit ligjor dhe në zbatim të definicioneve ligjore në fuqi për pavlefshmërinë absolute e ka zbatuar në

mënyrë rigoroze Vendimin nr. 148, datë 16.11.2020, e Komisionerit të Mbikqyrjes së Shërbimit Civil.

Lidhur me pretendimin e z. M.G. se “*diskriminimi ndaj tij ka vazhduar nga Bashkia Kamëz, pasi ish-pozicioni i tij, i punës është shpallur vakant, pa e njoftuar atë..*”, Bashkia Kamëz sqaron se në vendimin e KMSHC-së përcaktohet qartësisht: “*Të rregullohen pasojat duke e shpallur të lirë pozicionin e punës si specialist jurist...*” dhe jo siç pretendohet në interpretimin e ankesës së z. M.G., që institucioni punëdhënës ka detyrimin për të vënë në dijeni ish-punonjësin për publikimin e vendit vakant të pozicionit të punës. Shpallja e vendit vakant për pozicionin e punës “*specialist jurist*” është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz, me qëllim që të gjithë të interesuarit të paraqesin dosjen personale të punës, sipas kriterëve të përcaktuara për kualifikim. Në datën 20.01.2021, ish-punonjësi ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar kërkesën e tij për të aplikuar për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore*”.

Për sa më sipër, Bashkia Kamëz thekson faktin se mbyllja e procedurës për rekrutim për pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore*” është kryer në fazën e parë, pra të asaj të lëvizjes paralele dhe se aktualisht pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore pranë Bashkisë Kamëz nuk është plotësuar, në referencë të përcaktimeve të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të KQZ, “*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtrive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”.

1. Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 25.05.2021, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesja me autorizim e Bashkisë Kamëz dhe ankuesi M.G.. Ankuesi parashtrio edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të bindjes politike. Ai theksoi faktin se nuk ishte anëtar i ndonjë subjekti politik, por pretendimi i tij për diskriminim mbështetej në faktin se nuk ishte anëtar i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, si dhe në kushtet kur, ishte emëruar në detyrë nga ish-kryetari i Bashkisë Kamëz, supozohej se kishte bindje të djathta.

Ankuesi parashtrio pretendimet për diskriminim lidhur me situatat e paraqitura në ankesën e tij, duke filluar nga caktimi i tij anëtar i grupit të punës e deri tek konkurrimi për pozicionin e Drejtorit të Çështjeve Ligjore pranë Bashkisë Kamëz. Ai u shpreh se ishte specialisti me përvojë më të madhe pune në drejtorinë ku punonte, pasi punonjësit e tjerë kishin dhënë dorëheqjen pas ardhjes në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Kamëz. Në vijim, janë emëruar specialistët dhe drejtori i ri i kësaj drejtorie. Ankuesi pretendoi për trajtim të pafavorshëm, pasi ishte caktuar të punonte në një grup pune se: “*...ai nuk duhej përfshirë në këtë grup pune,*



*pasi ai nuk kishte specialist i kadastrës, por specialist jurist*”. Njëkohësisht, ai sqaroi se prezenca në këtë grup punë që paraqitej çdo ditë në Njësinë Administrative Paskuqan vërtetohej nëpërmjet kontrolleve të kryetarit dhe jo nëpërmjet listëprezencave. Ai shpreh se një fakt të tillë e ka bërë të ditur zyrtarisht në Bashkinë Kamëz, por nuk i është kthyer përgjigje. Njëkohësisht, ankuesi u sqaroi pretendimin vijues se i është dhënë vlerësim negativ (4) për periudhën janar-qershor 2020, nga ana e eprorit të tij të drejtpërdrejtë, ndërkohë që ky epror punonte vetëm prej 8-9 muajsh në pozicionin e Drejtorit Juridik. M.G. u shpreh se e ka ankimuar këtë vlerësim pune dhe ka kërkuar rivlerësim sapo është vënë në dijeni. I pyetur nëse ishte pjesë e shërbimit civil, z. M.G. u shpreh se emërimi i tij ishte bërë sipas Kodit të Punës dhe punonjësit e Bashkisë Kamëz trajtoheshin sipas dispozitave të këtij Kodit. Ndërkohë që, vlerësimi i ishte bërë si nëpunës civil. I pyetur sërish nëse Drejtuesi i tij i kishte tërhequr vëmendjen, lidhur me problematika të hasura në punë, ai u shpreh se nuk kishte patur kontakt me drejtorin për të tilla bashkëbisedime. Takimet me të konsistonin në dhënien e detyrave të reja. Vlerësimi i punës është ankimuar edhe në KMSHC dhe ky i fundit nuk është shprehur mbi vlefshmërinë e aktit, por mbi emërimin e tij në detyrë, i cili është i pavlefshëm. Në vijim, Bashkia Kamëz ka miratuar aktin e largimit të z. M.G. nga detyra. Ankuesi sqaron se është larguar nga puna në muajin nëntor 2020 dhe Bashkia Kamëz ka shpallur vakant pozicionin e drejtorit të drejtorisë juridike. Ai ka dërguar me postë dokumentacionin e kërkuar për të konkuruar, por në vijim procedurat e konkurimit janë mbyllur.

I pyetur për bindjet e tij politike, ai u shpreh se nuk ka bindje politike, por punëdhënësi ka prezumuar se ai ka patur bindje politike të djathta, pasi është emëruar në detyrë nga z. XH.M., i cili ka qenë përfaqësues i Partisë Demokratike. Ai thekson faktin se ky ka qenë edhe shkak i diskriminimit të tij. I pyetur nëse punonjës të tjerë të emëruar nga ish-Kryetari i Bashkisë Kamëz janë larguar nga puna për shkak të bindjeve politike, ai shprehet se nuk ka dijeni mbi një fakt të tillë. Por, sqaron se ka dijeni që ka punonjës që janë larguar nga puna si pasojë e vërejtjeve të njëpasnjëshme. I pyetur, nëse ata janë gjithashtu prezumuar se kanë bindje të djathta, ankuesi u përgjigj se ka ende punonjës të emëruar nga ish-kryetari, që vazhdojnë të punojnë pranë këtij institucioni.

Përfaqësuesja me autorizim e Bashkisë Kamëz, u shpreh se pretendimet e ankesit ishin të pabazuara dhe se asnjë veprim i Bashkisë Kamëz nuk konsistonte në diskriminim për shkak të bindjes politike apo prezumimit se ai ka bindje të djathta, pasi ai është emëruar në periudhën, kur ky institucion drejtohej nga ish Kryetari i Bashkisë, z. Xh.M. Ajo u shpreh se ka ende shumë punonjës të tjerë që janë emëruar nga ish-kryetari, të cilët vazhdojnë ende të punojnë pranë këtij institucioni.

Lidhur me pretendimin e parë, ajo u shpreh se pjesëmarrja e juristëve në grupe pune të institucionit është diçka normale, pasi në çdo grup punë të ngritur pranë Bashkisë Kamëz bëjnë pjesë juristët e Drejtorisë Juridike. Ajo u shpreh se në vijim të seancës dëgjimore do të

dërgonte disa urdhëra të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, nëpërmjet së cilëve ngrihen grupe pune, ku rezulton se specialistë të drejtorisë juridike janë pjesë e tyre.

Lidhur me pretendimin e dytë, që ka lidhje me vlerësimin në punë, përfaqësuesja e institucionit ra dakord me mendimin e përfaqësuesve të KMD-së se për sa kohë, z. M.G. nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil, ai nuk mund të vlerësohej sipas formularit tip, nëpërmjet së cilit vlerësohen nëpunësit civilë, si dhe ky vlerësim konsiderohet nul. E pyetur nëse ka përshkrime pune për punonjësit e Bashkisë Kamëz, ajo u përgjigj se në dijeninë e saj nuk ka përshkrime pune dhe detyrat e tyre përcaktoheshin në Rregulloren e institucionit. E pyetur përse Bashkia Kamëz nuk i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me vlerësimin e tij, përfaqësuesja e këtij institucioni u shpreh se Bashkia Kamëz i ka kthyer përgjigje zyrtare z. M.G., duke e njoftuar që do të bëhej rivlerësim. Ndërkohë që, eprori i tij, i drejtpërdrejtë, z. S.D., që i ka bërë vlerësimin e punës është larguar me dorëheqje.

Lidhur me çështjen e largimit nga puna të ankuesit, ajo u shpreh se Bashkia Kamëz ka vepruar konform vendimit të KMSHC, sipas së cilit duhej vendosur ligjshmëria mbi këtë pozicion pune. E pyetur nëse KMSHC kishte dalë me vendim vetëm për rastin e ankuesit, apo edhe për raste të tjera emërimesh, sikurse i z. M.G., përfaqësuesja e Bashkisë Kamëz u shpreh se KMSHC ishte shprehur vetëm për rastin e tij, pasi nuk kishte raste të tjera të ngjashme me të.

Lidhur me çështjen e konkurimit të ankuesit në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Juridike, përfaqësuesja e Bashkisë Kamëz u shpreh se konkurimet ishin pezulluar në zbatim të vendimarrjes së KQZ, para dhe përgjatë periudhës zgjedhore. Për me shumë të dhëna, ajo sqaroi se do të dërgonte informacion në vijim të seancës dëgjimore.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Kamëz dërgoi shkresën nr. 6110, datë 11.06.2021, nëpërmjet së cilës përcolli dokumentacionin e kërkuar në seancë dëgjimore, i cili konsistonte në aktet e mëposhtëme:

- Shkresa nr. 42 prot, datë 03.0.2019 *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”*;
- Shkresa nr. 01 prot., datë 06.01.2020 *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kamëz”*.
- Rregullore e Brendshme e Bashkisë Kamëz (2020);
- Vendim nr. 76 prot., datë 08.02.2021 *“Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz”*;
- Urdhër punë që shërbejnë si raste analoge për çështjen objekt shqyrtimi, ku vërtetohet që edhe juristët që janë pjesë e Sektorit Ligjor, janë atashuar me punë në struktura të tjera brenda Bashkisë Kamëz.

- Urdhër nr. 261 prot., datë 24.06.2020 “Për ngritjen e komisioni të posaçëm të rindërtimit për objektet kolektive” – ku pjesë e grupit kanë qenë edhe z. S.D. në cilësinë e Drejtorit Juridik dhe z. A.M. në cilësinë e specialistit jurist.
  - Urdhër nr. 108 prot., datë 24.02.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit” – ku pjesë e grupit ka qenë edhe z. L.D. në cilësinë e specialistit jurist;
  - Urdhër nr. 191 prot., datë 0.04.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e ankesave të qytetarëve që i adresohen Bashkisë” – ku pjesë e grupit të punës ka qenë znj. U.E. në cilësinë e Shefes së Sektorit Ligjor.
- Tabelë Ekseli e emërimeve të punonjësve nga ish-kryetari/që janë aktualisht pjesë e administratës së Bashkisë Kamëz – 98 punonjës;
  - Tabelë ekseli e largimeve të punonjësve të Bashkisë Kamëz 2019 – 46 punonjës;
  - Tabelë ekseli e largimeve të punonjësve të Bashkisë Kamëz 2020 – 31 punonjës;
  - Dorëheqjet e 41 punonjësve (me dëshirë) gjatë periudhës 2019-2020;
  - Vendim nr. 09, date 24.12.2020, të KQZ-së, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimi i veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve.”.
  - Shkresa nr. 1453 prot., datë 12.09.2019, e Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil;
  - Urdhër i Brendshëm nr. 65, datë 12.09.2019, i Kryetarit të Bashkisë, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjin për nëpunësin civil”.
  - Akt konstatimi datë 30.09.2019, mbajtur nga grupi i punës, KMSHC dhe Drejtori i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kamëz, ku është konstatuar se nuk ka patur raste shpallje/emërimi në kundërshtim me ligjin për nëpunësit civilë.

### **C. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

#### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Referuar dokumentacionit të depozituar në cilësi prove pranë Komisionerit, rezulton se z. M.G. ka filluar punë pranë Bashkisë Kamëz në pozicionin “specialist jurist” pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, nëpërmjet Urdhërit nr. 288 prot., datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 584, datë 20.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë institucion, me *motivacion “pavlefshmëri absolute e aktit nr. 288 prot., datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”*.

Pretendimet e ankuesit për diskriminim, për shkak të bindjes politike, fillojnë menjëherë pas ardhjes në detyrë të kryetarit aktual të Bashkisë Kamzës, z. Rakip Suli, i cili është përfaqësues i subjektit politik “Partia Socialiste”. Ankuesi pretendon se është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, në disa raste, të cilat do të analizohen si më poshtë vijojnë:

**1. Pretendimi për trajtim të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, lidhur me pjesëmarrje në grupin e punës, në Njësinë Administrative Paskuqan.**

Pretendimi i parë i ankuesit për diskriminim për shkak të bindjes politike konsiston në pjesëmarrjen e tij në grupin e punës të ngritur nëpërmjet Urdhërit nr. 248, datë 22.06.2020, të Kryetarit të këtij institucioni. Referuar këtij urdhëri, grupi i punës do të merrej me inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave të përfundimit të proceseve kalimtare të pronësisë pranë Njësisë Administrative Paskuqan, pa asnjë afat kohor. Ankuesi pretendon se ai nuk duhej përfshirë në këtë grup pune, pasi ai nuk ishte specialist i kadastrës, por specialist jurist.

Për sa më sipër, në kushtet kur për pozicionin “specialist jurist” nuk është depozituar në cilësi prove, një përshkrim pune, Komisioneri iu referua detyrave që pozicioni “specialist jurist” ka në bazë të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Kamëz (2019), si dhe Vendimit nr. 76, datë 08.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz “*Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz*”. Në të dy aktet e sipërcituara, rezulton se ndërmjet detyrave të ndryshme të përcaktuara për pozicionin “specialist jurist”, bën pjesë edhe detyra “*merr pjesë në Komisionet dhe grupet e punës, të ngritura me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kamëz*”.

Njëkohësisht vlen të përmendet fakti që Bashkia Kamëz ka depozituar në cilësi prove disa urdhëra të titullarit të këtij institucioni, nëpërmjet së cilëve rezulton se specialistët juristë janë pjesë e tyre. Për sa më sipër rezulton se:

1. Në Urdhërin nr. 191, datë 01.04.2021, e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “*Mbi ngritjen e grupit të punës për trajtimin e ankesave të qytetarëve që i adresohen bashkisë*” bëjnë

- pjesë 5 anëtarë, një ndër të cilët përkatësisht znj. U.E., përgjegjëse sektori, pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore;
2. Në Urdhërin nr. 108, datë 24.02.2020, e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit” bëjnë pjesë 5 anëtarë, një ndër të cilët është z. L.D., specialist jurist;
  3. Në Urdhërin nr. 261, datë 24.06.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit” bëjnë pjesë 5 anëtarë, dy ndër të cilët janë z. S.D. dhe A.M., Drejtor dhe specialist jurist, të Drejtorisë së Çështjeve Ligjore;

Lidhur me çështjen e ngritur nga ankuesi se prezenca fizike në punë e Strukturës së Posaçme, të krijuar me Urdhërin nr. 248, datë 22.06.2020, e Kryetarit të Bashkisë Kamëz, verifikohet nga Kryetari i Njësisë Administrative Paskuqan, i cili kontrollonte nëpër zyra për të konstatuar praninë e këtyre punonjësve dhe jo nëpërmjet listëprezencës, Komisioneri gjykon se M.G. nuk i ka ardhur ndonjë pasojë negative apo nuk është penalizuar, si rrjedhim i zbatimit të një procedurë të tillë. Kjo procedurë ka qenë e njëjtë për të gjithë anëtarët e grupit të punës dhe jo specifikisht për ankuesin.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kamëz.

## **2. Pretendimi për trajtim të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, lidhur me vlerësimin në punë, të z. M.G., për periudhën janar-qershor 2020.**

Në bazë të pikës 1, germa a), të Kreut II, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo i dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj të vitit kalendarik.

Ankuesi pretendon se në datën 10.08.2020 është vënë në dijeni të faktit se është vlerësuar në nivelin “jo kënaqshëm”, për periudhën janar-qershor 2020, nga ana e z. S.D., drejtor pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, pranë Bashkisë Kamëz.

M.G. ka theksuar faktin se procesi i vlerësimit të rezultateve të tij në punë është kryer në kundërshtim me pikat 10 dhe 12, të Kreut II, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar. Ai shprehet se vlerësimi i tij është kryer në mënyrë të njëanshme dhe se ai nuk është njoftuar asnjëherë për fillimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, planifikimin, ecurinë e

verifikimeve të rezultateve, apo të njoftohet për bisedime të ndërmjetme në mes të periudhës së vlerësimit sipas aktit nënligjor të sipërcituar.

Ankuesi pretendon se eprori i tij e ka diskriminuar në vlerësimin e kryer ndaj tij, pasi ky vlerësim është kryer në kundërshtim me ligjin. M.G. ka refuzuar të nënshkruajë vlerësimin e punës, si dhe ka depozituar ankimimin nr. 6625, datë 31.08.2020, pranë Kryetarit të Bashkisë Kamëz, në cilësinë e zyrtarit kundërfirmues, ankimimin e datës 11.09.2020, pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) dhe ankimimin nr. 679, datë 11.09.2020, pranë KMSHC-së;

Nëpërmjet shkresës nr. 4199/1, datë 24.09.2020, DAP-i i ka kthyer përgjigje ankuesit, ku e informon mbi mënyrat për të ushtruar të drejtën e ankimit, në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civilë, përkatësisht: (1) pranë titullarit të institucionit, (2) pranë gjykatës kompetente për mosmarrëveshjet administrative dhe (3) pranë KMSHC-së, si institucioni përgjegjës për mbikqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Bashkia Kamëz i dërgoi përgjigje ankuesit, nëpërmjet shkresës nr. 6625/1, datë 23.09.2020, duke e informuar si vijon: *“Ankimi juaj është marrë në konsideratë dhe do merret në rishqyrtim për një vlerësim të rezultateve në punë gjatë periudhës janar - qershor 2020 nga Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik në Bashkinë Kamëz.”*

Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, pasi kërkoi informacionin e nevojshëm nga Bashkia Kamëz, nëpërmjet shkresës nr. 679/1, datë 23.09.2020 së dërguar pranë këtij institucioni për të kryer verifikimet e nevojshme mbi ankesën e z. M.G., u shpreh me Vendimin nr. 148, datë 16.11.2020, ku citohet: *“...Në vlerësim të akteve ligjore dhe nënligjore përmendur më lart, arrihet në përfundimin se, punonjësi M.G., me detyrë “Specialist jurist”, pranë Bashkisë Kamëz, nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, e për pasojë, në këtë rast nuk mund të aplikohen të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i institutit të vlerësimit të punës parashikuar në ligjin për shërbimin civil”.*

Përfundimi i mësipërm është arritur pasi, mbështetur në dosjen personale të ankuesit rezulton se ai është emëruar në detyrë nëpërmjet Urdhërit nr. 288 prot., datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz në pozicionin *“specialist jurist”* pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike. Në këtë kontekst, rezulton se për punësimin e ankuesit nuk janë ndjekur procedurat e parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil, rekrutimi i tij nuk është kryer nëpërmjet konkurimit, sikurse parashikohet nga dispozitat përkatëse ligjore dhe si rrjedhim ai nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, i cili vlerësohet në bazë të dispozitave të VKM-se së sipërcituar.



Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri ndan të njëjtin mendim me KMSHC-në dhe gjykon se vlerësimi i punës sipas dispozitave të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar kryhet vetëm për punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe jo për ata punonjës që janë emëruar në kundërshtim me këto parashikime. Referuar edhe përcaktimit të kryer nga ana e KMSHC, Komisioneri gjykon se vlerësimi i punës së kryer për z. M.G. është i pavlefshëm dhe nuk mund të ketë efekt ligjor mbi ankuesin.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë e disfavorizues nga ana e Bashkisë Kamëz.

### **3. Pretendimi për trajtim të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, lidhur me lirin nga detyra të z. M.G., nga ana e Bashkisë Kamëz.**

Me Vendimin nr. 148, datë 16.11.2020, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi M.G., në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2020, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, institucioni Bashkia Kamëz”, Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil është shprehur jo vetëm në lidhje me çështjen e vlerësimit në punë të z. M.G., që ishte objekt ankese, por mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga Bashkia Kamëz, ka marrë në shqyrtim edhe çështjen e emërimit të tij në detyrë.

Në vendimin e sipërcituar, KMSHC ka konstatuar se: “.....punonjësi M.G. ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me Urdhërin “Për emërim në detyrë”, nr. 288, datë 24.09.2018, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, në pozicionin e punës “Specialist Jurist”, pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, të kësaj Bashkie, me një periudhë prove dy (2) mujore, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Më tej, nga ana e institucionit nuk është ndjekur asnjë procedurë për të plotësuar këtë pozicion pune sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, fakt i cili provohet nga përmbajtja e dosjes personale të këtij punonjësi, në të cilën nuk gjendet asnjë dokumentacion që të provojë pranimin e tij në shërbimin civil sipas kërkesave të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse..... Urdhëri “Për emërim në detyrë”, nr 288, datë 24.09.2018....është një urdhër i nxjerrë në kundërshtim me procedurën e parashikuar në dispozitat ligjore që rregullojnë pranimin në shërbimin civil..... gjë që në bazë të pikës a/ii, të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” e bën aktin absolutisht të pavlefshëm e për rrjedhojë punonjësi M.G. nuk mund të jetë pjesë e shërbimit civil. Në këto kushte, njësia përgjegjëse e institucionit bazuar në germën ç), të nenit 65, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet të konstatojë pavlefshmërinë e aktit të emërimit për punonjësin M.G., duke bërë

**njëkohësisht edhe ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për këtë punonjës”.**

Mbështetur sa më sipër, nëpërmjet Urdhërit nr. 584, datë 20.11.2020 “Për lirim nga detyra”, z. Marjon M.G. lirohet nga detyra si “*specialist jurist*” pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore e Prokurimit Publik, me motivacionin “*pavlefshmëri absolute e aktit nr. 288 prot., datë 24.09.2018*”.

Në pikat 1 dhe 2, të dispozitivit të vendimit nr. 9/2020 të KMSHC-së, citohet shprehimisht: “*1. Të kërkojë nga Kryetari i Bashkisë Kamëz, me synim rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 288, datë 24.09.2018, nëpërmjet të cilit punonjësi M.G. është emëruar në kundërshtim me ligjin në pozicionin e punës “specialist jurist”, në Bashkinë Kamëz. 2. Të rregullohen pasojat duke e shpallur të lirë pozicionin e mësipërm, për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil.*”

Ankuesi pretendon se Bashkia Kamëz ka vepruar në tejkalim të kërkesave të KMSHC-së, duke e liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 584, datë 22.11.2020, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, “Për lirim nga detyra”, me motivacionin “*pavlefshmëri absolute e aktit nr. 288, datë 24.09.2018*”, ndërkohë që nga analizimi i Vendimit të KMSHC-së rezulton se ky institucion ka kërkuar shprehimisht nga Bashkia Kamëz ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil për këtë punonjës.

Mbështetur në shkresën nr. 1453 prot., datë 12.09.2019, e KMSHC-së, titullari i Bashkisë Kamëz ka miratuar Urdhërin nr. 65, datë 12.09.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”. Referuar Akt-konstatimit të grupit të punës rezulton se pranë këtij institucioni evidentohen 114 pozicione pune të shërbimit civil, nga të cilat 18 pozicione rezultojnë të lira dhe 1 pozicion është i lirë për shkak të ligjit, pasi rezulton të jetë plotësuar me punonjës të emëruar me akte të përkohshme emërimi, pa respektuar procedure e konkurimit të përcaktuar në ligjin për nëpunësin civil. Për sa më sipër rezulton se pozicioni i znj. H.N., në pozicionin “Përgjegjës IT”, është konstatuar si pozicion, ku emërimi është kryer në kundërshtim me ligjin. Për këtë pozicion është proceduar menjëherë duke e shpallur vakant dhe duke filluar procedurat e konkurrimit. Ndërkohë që nuk janë konstatuar raste të tjera, ku punonjësit janë emëruar në kundërshtim me ligjin.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Kamëz.

#### **4. Pretendimi për trajtim të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, lidhur me mbylljen e procedurave të konkurimit për pozicionin e Drejtorit të Çështjeve Ligjore, nga ana e Bashkisë Kamëz.**

Nëpërmjet Njoftimit nr. 04, datë 19.01.2021, të Bashkisë Kamëz është shpallur procedura për plotësimin e pozicionit vakant të Drejtorit të Çështjeve Ligjore pranë këtij institucioni. Referuar këtij njoftimi, rezulton se afati për dorëzimin e dokumentave për **“Lëvizje paralele”** ishte deri në datën 28.01.2021, afati për dorëzimin e dokumentave për **“Ngritje në detyrë”** ishte deri në datën 04.02.2021 dhe afati për dorëzimin e dokumentave për **“Pranim në shërbim civil”** ishte 12.02.2021.

Në njoftimin e sipërpërmendur citohet: *“Pozicionet më sipër u ofrohen nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe për pranim në shërbimin civil”.*

Në nenin 26, pika 1, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.”*

Në datën 20.01.2021, ankuesi ka dërguar nëpërmjet shërbimit postar, kërkesën e tij për të aplikuar për pozicionin e sipërcituar, për procedurën **“Pranim në shërbimin civil”**, pasi i plotësonte të gjitha kriteret respektive. Kërkesa e tij është marrë në dorëzim nga Bashkia Kamëz, fakt që vërtetohet nëpërmjet lajmërim-marrjes përkatëse. Procedura **“Pranim në shërbimin civil”** ishte faza e tretë e konkurrimit, për ata aplikantë, të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil. Konkurimi për këtë procedurë do të zhvillohej vetëm nëse pozicioni i shpallur vakant nuk do të plotësohej nëpërmjet konkurimit për procedurën **“Lëvizje paralele”** dhe procedurën **“Ngritje në detyrë”**. Referuar nenit 26, pika 3, gërmat a) dhe b), të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për procedurën **“Lëvizje paralele”** kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil, ndërkohë që për procedurën **“Ngritje në detyrë”** kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Në vijim, nëpërmjet njoftimit nr. 04/1, datën 29.01.2021, Bashkia Kamëz njofton për mbylljen e procedurës së pranimit në pozicionin e lartpërmendur, pasi nuk ka patur asnjë aplikant. Ky institucion e ka justifikuar mbylljen e procedurës së konkurimit për këtë pozicion pune, si rrjedhim i parashikimeve të Vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të KQZ-së, “*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimi i veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve.*”. Qëllimi i këtij vendimi ishte vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.<sup>5</sup>

Në nenin 3, pika 1.3, germa d) të vendimit të sipërcituar parashikohet disa nga veprimtaritë e ndaluara shprehimisht: “*Veprimtari të ndaluara*”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:.....  
d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat ne organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

Për sa më sipër, rezulton se gjatë fushatës zgjedhore është i ndaluar rekrutimi i punonjësve, përveçse në raste të përligjura, të cilat konsiderohen rastet, kur marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Fushata zgjedhore për zgjedhjet kombëtare për Kuvendin e Shqipërisë ka filluar në datën **25 mars 2021**, ndërkohë që nga të dhënat e administruara rezulton se shpallja e pozicionit vakant “Drejtor i Çështjeve Ligjore” pranë Bashkisë Kamëz është kryer në datën **19.01.2021**, pra para fillimit të kësaj fushate. Njëkohësisht, afati i fundit për dorëzim dokumentacioni nga aplikantët për procedurën “*Pranim në shërbimin civil*” ishte data **12.02.2021**.

---

<sup>5</sup> Referuar Nenit 1 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të KQZ-së;

Përveç sa më sipër, në Njoftimin nr. 04/1, datën 29.01.2021, Bashkia Kamëz justifikon mbylljen e procedurës, pasi nuk ka patur aplikantë, pa dhënë shpjegimet përkatëse se përse nuk kanë vijuar procedurat përkatëse për **“Ngritje në detyrë”** dhe **“Pranim në shërbimin civil”**. Nëse justifikimi i këtij institucioni do të ishte vërtet i mbështetur në parashikimin e Vendimit nr. 9/2020 të KQZ-së, njoftimi do të pezullonte procedurat e konkurimit, deri në përfundimin e fushatës zgjedhore, por jo të konsideronte të mbyllur procedurën e pranimit në tërësi për këtë pozicion pune. Komisioneri gjykon se nëse për procedurën **“Lëvizje paralele”** nuk ka patur aplikantë, Bashkia Kamëz duhet të vijonte me procedurat **“Ngritje në detyrë”** dhe **“Pranim në shërbimin civil”**. Njëkohësisht, Bashkia Kamëz nuk ka dërguar në cilësi prove, për të justifikuar veprimin e saj, mbylljen e procedurave konkurruese për pozicione të tjera të shpallura vakante përgjatë së njëjtës periudhë kohore.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesi është “penalizuar” dhe i është mohuar e drejta për të konkuruar për pozicionin vakant “Drejtor i Çështjeve Ligjore” pranë Bashkisë Kamëz. Në këto kushte, ai është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Kamëz.

## **B. Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.**

Z. M.G. pretendon diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*, nga ana e Bashkisë Kamëz.

*“Bindja politike”* është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*, Komisioneri gjykon se *“bindja politike”* konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Komisioneri çmon gjithashtu se edhe pse ankuesi nuk ka anëtarësi në ndonjë subjekt politik dhe nuk është militant i ndonjë force politike, sërisht pretendimi i tij se kryetari aktual i Bashkisë Kamëz e ka diskriminuar, pasi ai është emëruar në detyrë nga ish-kryetari i kësaj Bashkie, që i përkiste subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, si dhe ngaqë nuk është anëtar i partisë Socialiste të Shqipërisë, konsiderohet shkak diskriminimi.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se z. M.G. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Kamëz, pasi i është mohuar e drejta për të konkuruar në pozicionin vakant “Drejtor i Çështjeve Ligjore”, pranë këtij institucioni.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: *“....Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”*.

Referuar vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë<sup>6</sup>, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e tij të nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: *“Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimin të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit”* (paragrafi 55).

---

<sup>6</sup> Redfearn v The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në nenin 12, pika 1, gërmat b) dhe (c), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative<sup>7</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Kamëz, e cila duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk

<sup>7</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

*përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Kamëz, që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të bindjes së tij politike.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS<sup>8</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>9</sup>

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Bashkisë Kamëz, pasi atij i është mohuar e drejta dhe mundësia për të konkuruar për pozicionin vakant “Drejtor i Çështjeve Ligjore”, pasi Bashkia Kamëz ka mbyllur procedurën e pranimit për këtë pozicion, me arsyetimin se nuk ka patur aplikantë. Njëkohësisht, Komisioneri gjykoj se

<sup>8</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

<sup>9</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

justifikimi i këtij institucioni, se mbyllja e procedurës është kryer konform parashikimit të Vendimit nr. 9/2020 të KQZ, është gjetur i pambështetur, pasi referuar nenit 3, pika 1.3, germa d) të këtij vendimi ndalohej rekrutimi gjatë fushatës zgjedhore, e cila filloi në datën 25 mars 2021, ndërkohë që procedurat e rekrutimit për pozicionin e sipërcituar kanë filluar janar 2021. Njëkohësisht, referuar parashikimit të këtij neni rezulton se rekrutimi i punonjësve mund të bëhej në raste të përligjura, ku si rast i tillë është cituar **“marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij.”**

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton se z. M.G. është emëruar në detyrë me Urdhërin nr. 288 prot., datë 24.09.2018, të ish-kryetarit të Bashkisë Kamëz, z. Xh.M., i cili ishte përfaqësues i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Njëkohësisht, KMD nuk disponon asnjë kopje karte anëtarësie të ankuesit në ndonjë forcë politike, përfshirë këtu edhe në Partinë Socialiste.

Për sa më sipër, Bashkia Kamëz e ka informuar Komisionerin se tendenca e kryetarit aktual të këtij institucioni nuk ka qenë të largojë punonjësit e emëruar nga ish-titullari i tij, pasi mbështetur në provat e depozituara gjatë procedurës administrative rezulton se 98 punonjës të emëruar nga ish-kryetari i kësaj bashkie punojnë ende pranë këtij institucioni. Në këtë kontekst, për analogji është gjykuar se shkaku i pretenduar nga ankuesi, nuk mund të jetë i mbështetur dhe i bazuar, edhe në rastin e rekrutimit të tij për pozicionin vakant të “Drejtorit të Çështjeve Ligjore”. Njëkohësisht, mbyllja e procedurave të pranimi për pozicionin e sipërcituar ka penalizuar edhe aplikantët e mundshëm për procedurën **“Ngritje në detyrë”** dhe jo vetëm z. M.G., i cili do të konkuronte për procedurën pasardhëse **“Pranim në shërbimin civil”**.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se arsyetimi i Bashkisë Kamëz është i pranueshëm dhe se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ndaj së cili z. M.G. është ekspozuar nga ana e këtij institucioni.

Në këtë kontekst, KMD gjykon se nuk ka diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 **“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”**, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. M.G., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Kamëz.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha – Punësim  
Shkak – bindja politike  
Lloji i vendimit - mosdiskriminim